



Metoda Kërkimi

Prof. Asoc. Dr. Ezmolda Barolli



Kapitulli 1

Natyra e Kërkimit në Biznes dhe Menaxhim



Objektivat

- Të dini të dalloni qëllimin dhe fokusin e kërkimit shkencor në biznes dhe menaxhim
- Të jeni të aftë të zbatoni projektin tuaj të kërkimit shkencor mbi një bazë të aplikueshme
- Të kuptoni fazat të cilat duhet ti plotësoni si pjesë e kërkimit shkencor
- Të njiheni me strukturën e modulit



Përmbajtja

1. **Hyrje**
2. **Natyra e kërkimit**
3. **Natyra e kërkimit në biznes dhe menaxhim**
4. **Proçesi i kërkimit**
5. **Qëllimi dhe struktura e librit**
6. **Përmbledhje**

1. Hyrje

- **“Metodat e Kërkimit”** do t’ju ofrojnë një **guidë** të qartë për mënyrën se si të ndërmerri iniciativën për të realizuar kërkimin shkencor
 - *Nuk ka rëndësi nëse jeni një student apo një menaxher*
- Moduli do t’ju pajisë me njohuritë dhe aftësitë për të gjitha **hapat** që nga përcaktimi i një tematike kërkimi deri tek shkrimi i punimit
 - *Raport projekti, mikrotezë, disertacion*
- Do të jeni të aftë që të bëni **zgjedhjet e duhura** për mënyrat, strategjitë dhe metodat që janë më të përshtatshme për kërkimin tuaj dhe **ti justifikoni** ato
 - *Nuk ka asnjë mënyrë të vetme, si më e mira, për të ndërmarrë të gjitha kërkimet*
- Do të mësoni **teknikat** për mbledhjen dhe analizimin e e të dhënave
 - *Do të kuptoni sa e rëndësishme është Teknologjia e Informacionit në këto procese*
- Pavarësisht, ju duhet **të lexoni** një sërë librash dhe artikujsh të tjerë për të arritur objektivat e kërkimit tuaj



Metodat dhe Metodologjia

Pavarësisht se shpesh këto terma mund të shkëmbehen, në këtë modul do të diferencojmë kuptimin e të dyjave:

- **Metodat** – teknikat dhe procedurat që përdoren për të përfituar dhe analizuar të dhënat.
 - Strategjitë
 - Pyetsorët
 - Observimet
 - Intervistat
 - Teknika analizimi sasiore dhe cilësore, etj.
- **Metodologjia** – teoria mbi të cilën bazohet kërkimi shkencor dhe shpjegon se si duhet të ndërmeret ai. Përfshin filozofitë dhe metodat
 - Filozofitë
 - Pozitivizmi, Pragmetizmi, etj.

2. Natyra e kërkimit

- Çdo ditë ne përballemi me termin “**kërkim shkencor**” dhe “**rezultatet e kërkimit shkencor**”
 - Gazetat publikojnë opinione të njerzve të bazuara mbi “kërkimet”
 - Politikanët justifikohen se marrin vendime për politika të ndryshme mbi bazën e “kërkimeve”
 - Kompanitë deklarojnë observime për “kërkime” tregu
 - Dokumentarët na tregojnë për gjetje të ndryshme nga “kërkimet” dhe reklamojnë produkte duke pohuar se kanë cilësi të ndryshme bazuar në “rezultatet e kërkimeve”
- Një **gamë e gjerë kuptimesh** i jepen termit “kërkim shkencor” në gjuhën e përditëshme
 - Por jo gjithmonë këto përdorime të këtij termi janë “kërkim shkencor” në kuptimin e vërtetë të fjalës

Natyra e kërkimit

Rastet kur termi “kërkim” përdoret gabim:

- **Mbledhja e fakteve ose informacioneve pa ndonjë qëllim të qartë**
 - Nuk mjafton thjesht mbledhja e informacionit, intervistimi i disa njerzve, etj, kjo është vetëm një pjesë e punës, e cila duhet bërë në mënyrë sistematike dhe me një qëllim të caktuar
- **Grumbullimi dhe renditja e fakteve ose informacioneve pa i interpretuar ato**
 - Këtë e gjejmë në çdo raport apo listë me informacione nga burime të ndryshme, por nuk mund ta quajmë kërkim
- **Keni si qëllim që produkti ose idea juaj të evidentohet dhe vlerësohet**
 - Kjo ndodh kur doni ti jepni më shumë rëndësi punës tuaj, dhe kur pyeteni për detajet e procesit të kërkimit nuk do të jeni i aftë të përgjigjeni

Kërkimi

“Kërkimi” i vërtetë ka një sërë karakteristikash:

- Të dhënat janë mbledhur sistematikisht
- Të dhënat janë interpretuar sistematikisht
- Ka një qëllim të qartë për të zbuluar gjërat

Përkufizim:

Kërkimi shkencor është një proçes që e ndërmarrin njerzit, në mënyrë që të zbulojnë gjërat në mënyrë sistematike, duke rritur kështu nivelin e njohurive të tyre.



Proçesi i kërkimit

- **“Kërkim sistematik”** – kërkimi bazohet mbi relacione logjike dhe jo thjesht mbi besimin
 - Duhet të përfshijë shpjegime për:
 - Metdodat e përdorura për mbledhjen e të dhënave
 - Pse rezultatet kanë kuptim
 - Kufizimet e mundëshme
- **“Të zbulojë gjëra”** – mund të ketë një sërë qëllimesh kërkimi
 - Të cilat mund të jenë:
 - Përshkrimi
 - Shpjegimi
 - Kuptimi
 - Kritika
 - Analizimi
 - Ose të keni përcaktuar një sërë pyetjesh për t’ju përgjigjur

3. Natyra e kërkimit në biznes dhe menaxhim

- **Kërkimi në biznes dhe menaxhim është ndërmarrja e kërkimit sistematik për të zbuluar gjërat në lidhje me biznesin dhe menaxhimin**
- Arsyet pse fushat e biznesit dhe menaxhimit janë një fokus i mirë kërkimi:
 - Menaxherët shfrytëzojnë njohuritë e disiplinave të tjera dhe përdorin njohuri nga një sërë disiplinash
 - Menaxherët bëjnë kërkime nëse ata shikojnë avantazhe komerciale ose personale
 - Menaxherët kërkojnë që kërkimi shkencor të ketë disa rrjedhime praktike
 - Menaxherët kanë tendencë të jenë po aq të shkolluar sa edhe kërkuesit shkencorë

Debatet për natyrën e kërkimit

- Si mund të përmbushë kërkimi në biznes dhe menaxhim të dyja qëllimet???
- Të jetë rigoroz nga ana teorike dhe metodologjike
- Të përqafojë botën e praktikës dhe të jetë me vlera për të
- Shumica e këtyre debateve përqëndrohen dhe mbështeten tek 2 mënyrat e **prodhimit të njohurive** (Gibons 1994):
 - **Mënyra 1**
 - Kërkimi në të cilin pyetjet ngrihen dhe zgjidhjen nga interesa akademike, duke theksuar një natyrë fundamentale më shumë sesa të aplikuar, duke pasur pak ose aspak përdorim të kërkimit nga prakticienët
 - **Mënyra 2**
 - Thekson një kontekst të kërkimit të drejtuar nga bota e praktikës, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit midis prakticienëve, dhe nevojën për prodhimin e njohurive me rëndësi praktike




Konkluzionet

- **Kërkimi në biznes dhe menaxhim jo vetëm që duhet të prodhojë gjetje dhe të zgjerojë njohuritë dhe të kuptuarin, por edhe të fokusohet tek çështje të biznesit dhe probleme praktike menaxheriale**
- Bazuar në këtë ide sipas Huff and Huff 2001, kemi një mënyrë të 3 të prodhimit të njohurive:
 - **Mënyra 3**
 - Fokusohet në vlerësimin e kushteve humane, si janë dhe si mund të jenë në të ardhmen, qëllimi i tyre është të sigurojë mbijetesën dhe të mirën e përgjithëshme në nivele të ndryshme të grupimeve sociale
- Theksohet rëndësia e një **zgjerimi të çështjeve me rëndësi** për njerzit mbi të cilat bazohet kërkimi
- Brenda kufijve kaq të gjerë qëllimi dhe konteksti i kërkimit mund të ndryshojë shumë

Shtrirja

- Të gjithë projektet kërkimore të biznesit dhe menaxhimit mund ti vendosim në një linjë të vazhduar sipas qëllimit dhe kontekstit
- Në njërin ekstrem është kërkimi që bëhet për të kuptuar proceset e biznesit dhe menaxhimit dhe rezultatet e tyre – nga ana tjetër kërkimi që ka lidhje direkte me menaxherët, i adresohet çështjeve të tyre më të rëndësishme, dhe paraqitet në mënyra që mund të kuptohet lehtë





Dyshimet

- **Ju mund të mendoni që rezultatet e kërkimit tuaj mund të kenë vlera neutrale ose mund të mos kenë vlera fare**
- **Kërkimi nuk duhet të influencohet nga ndjesitë tuaja, por:**
 - Tematika
 - Mënyra si i mblidhni dhe analizoni të dhënat
 - Aftësitë tuaja për të zhvilluar kërkimin



4. Proçesi i kërkimit

- **Kërkimi paraqitet si një proçes me shumë faza të cilat duhet të ndiqen për të realizuar të gjithë projektin:**
 - Formulimi dhe qartësimi i temës
 - Rishikimi i literaturës
 - Dizajnimi i kërkimit
 - Mbledhja e të dhënave
 - Analizimi i të dhënave
 - Shkrimi i punimit
- Hapat duhet të ndiqen njëri pas tjetrit
- Duhet ti ktheheni përsëri rezultateve të secilës fazë më shumë se një herë për të rafinuar idetë



Çështje që duhen konsideruar

- **Impakti i ndjesive tuaja personale dhe besimit**
- **Aksesi tek të dhënat**
- **Koha dhe burimet e tjera**
- **Vlefshmëria dhe besueshmëria e të dhënave**
- **Çështje të etikës**



5. Qëllimi dhe struktura e librit

Qëllimi:

T'ju ndihmojë të ndërmerrni kërkimin duke qenë të qartë për:

- Atë që jeni duke bërë
- Pse jeni duke e bërë
- Implikimet e lidhura me atë që keni ndërmend të bëni
- Si lidhen idetë tuaja me kërkimet e mëparëshme në të njëjtën fushë
- Si do ti mblidhni dhe analizoni të dhënat
- Vlefshmërinë dhe besueshmërinë e të dhënave
- Çëshjtet e etikës dhe të aksesit
- Përshtatshmërinë e teknikave të analizimit
- Shkrimin dhe prezantimin sa më mirë të projektit



Struktura

Secili kapitull përmban:

- Përmbledhje të pikave kryesore
- Pyetje vetë kontrolli – dhe përgjigjet
- Pyetje rishikimi dhe diskutimi
- Referenca dhe lexime të mëtejshme
- Një studim rasti që thekson çështjet reale të kërkimit



6. Përmbledhje

Kërkimi në biznes dhe menaxhim

- Është ndërdisiplinor
- Ndërthuret si me teorinë dhe praktikën
- Mund të shrihet në një vazhdimësi nga bazik-tek-i aplikuar
- Përfshin ndërmarrjen e një kërkimi sistematik
- Duhet të ndërmerret me rigorozitet
- Është një proces shumë fazash



Së fundi...

“nuk ka asnjë rrugë që është më e mira për të ndërmarrë kërkimin”

Saunders et al. (2009)